



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 7636 Prot.

Tiranë, më 16.07. 2018

URDHËR

Nr. 920, datë 16.07.18

**PËR
HAPJEN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT "MASTER I
SHKENCAVE" NË "FINANCË DHE TREGJE FINANCIARE" TË KOLEGJIT
UNIVERSITAR "REALD"**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenit 18, 35, 69 dhe 75 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Hapjen e programit të ciklit të dytë të studimit që realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 2 vite (4 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e ciklit të dytë "Master i shkencave" në "Financë dhe Tregje Financiare", në Fakultetin e Ekonomisë, në Kolegjin Universitar "Reald".
2. Veprimtaria akademike për programin ciklit të parë të studimit në "Financë dhe Tregje Financiare" fillon në vitin akademik 2018-2019.
3. Kolegji Universitar "Reald", të plotësojë rekomandimet e ekspertit dhe t'i nënshtrohet procesit të akreditimit lidhur me këtë program studimi, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin, Kolegji Universitar "Reald".
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij Urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Derregullimit, Lejeve, Licensave dhe Monitorimit në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Kolegji Universitar "Reald"

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Lindita Nikolla

